



Në bazë të nenit 35, paragrafi 1, nënparagrafit 1.1, dhe nenit 65, paragrafët 1 dhe 2, të Ligjit nr. 03/L/209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 77/16 Gusht 2010), të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-150 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/03 Prill 2017), si dhe nenit 8 dhe nenit 108, paragrafi 5, të Ligjit Nr. 08/L-304 për Bankat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 2/27 janar 2026), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 qershor 2026, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR INSTRUMENTIN E SHITJES SË VEPRIMTARISË TREGTARE

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Kjo rregullore përcakton kushtet, kërkesat dhe procedurat me qëllim të zbatimit të instrumentit të shitjes së veprimtarisë në zbatim të procesit të përmbylljes së bankave.
2. Kjo rregullore zbatohet për të gjitha bankat në Republikën e Kosovës, të licencuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, duke përjashtuar degët e bankave të huaja.

Neni 2

Përkufizimet

1. Të gjitha shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë përkufizimin siç përcaktohet në nenin 3 të Ligjit Nr. 08/L-304 për Bankat, dhe/ose siç përcaktohet në vijim për qëllimin e kësaj rregulloreje:
 - 1.1. **Ligji për Bankat:** nënkupton Ligji Nr. 08/L-304 për Bankat;
 - 1.2. **BQK si autoritet mbikëqyrës:** nënkupton Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës si autoritet mbikëqyrës, ose licencues.
 - 1.3. **Instrumenti i shitjes së veprimtarisë tregtare-** nënkupton mekanizmin e BQK-së për iniciimin e transferimit të aksioneve ose instrumenteve tjera të pronësisë të emetuara nga banka nën procesin e përmbylljes, ose transferimin e aseteve (pasuritë), të drejtat dhe detyrimet e bankës nën procesin e përmbylljes tek një blerës që nuk është institucion urë, në përputhje me nenin 108 të Ligjit për Bankat.
 - 1.4. **Instrumentet e përmbylljes-** nënkupton instrumente të përmbylljes të përcaktuara në nenin 107 të Ligjit për Bankat.
2. Përveç rasteve kur specifikohet ndryshe, referencat për BQK-në në këtë rregullore, interpretohen për BQK-në në cilësinë e autoritetit të përmbylljes.

Neni 3

Kushtet për zbatimin e instrumentit të shitjes së veprimtarisë

1. BQK mund të zbatoj instrumentin e shitjes së veprimtarisë për bankat që përmbushin kushtet e zbatueshme për përmbyllje, siç përcaktohet me nenin 106 të Ligjit për Bankat. Ky instrument mund të zbatohet individualisht ose në kombinim me instrumente tjera të përmbylljes të përcaktuara me Ligjin për Bankat.
2. BQK mund t'i transferojë blerësit, i cili nuk është institucion urë:
 - 2.1 aksionet apo instrumentet tjera të pronësisë, të emetuara nga banka nën procesin e përmbylljes;
 - 2.2 të gjitha apo disa asete, të drejta apo detyrime të bankës nën procesin e përmbylljes.
3. Nëse BQK vendos për fillimin e procedurës së përmbylljes dhe përcakton se përmbyllja do të zbatohet, tërësisht ose pjesërisht, nëpërmjet shitjes së aseteve, të drejtave ose detyrimeve të bankës në proces të përmbylljes, BQK merr vendim për realizimin e shitjes.
4. Kur vendimi për përmbyllje përcakton se përmbyllja do të zbatohet nëpërmjet shitjes së aksioneve ose instrumenteve të tjera të pronësisë të emetuara nga banka në proces të përmbylljes, BQK merr vendim për shitjen e këtyre instrumenteve të pronësisë të blerësi i caktuar.
5. Çdo transferim i përcaktuar në këtë rregullore duhet të jetë në pajtueshmëri me Ligjin për Bankat dhe nuk i nënshtrohet miratimit të aksionarëve të bankës në proces të përmbylljes, të kreditorëve të saj apo të palëve të treta.
6. Banka në proces të përmbylljes njofton, pa vonesë / sa më shpejtë që është e mundur, personat ndaj të cilëve vendimi ka efekt, në pjesën që i përket atyre, lidhur me vendimin e shitjes të përcaktuar në paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni.
7. BQK mund ta realizojë shitjen e përcaktuar në paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni në tërësi ose pjesërisht.
8. Blerësi që ka fituar instrumente të pronësisë të bankës nën përmbyllje në përputhje me këtë nen gëzon të gjitha të drejtat pronësore që rrjedhin nga këto instrumente të pronësisë.
9. Kur BQK vendos të zbatojë instrumentin e shitjes së veprimtarisë tregtare dhe se ky veprim do të rezultojë në humbjet që do të barten nga aksionarët apo kreditorët ose ku pretendimet e tyre zvogëlohen ose konvertohen, përfshirë përmes aplikimit të instrumentit të rikapitalizimit nga brenda, BQK ushtron kompetencën për të zvogëluar vlerën dhe për të konvertuar instrumentet e kapitalit në përputhje me nenin 112 të Ligjit për Bankat, menjëherë para ose së bashku me aplikimin e instrumentit të shitjes së veprimtarisë tregtare. Kompetenca për zvogëlimin e vlerës apo konvertimin në lidhje me detyrimet e një banke në proces të përmbylljes, në përputhje me nenin 111 të Ligjit për Bankat, mund të zbatohet gjithashtu në kombinim me instrumentin e shitjes së veprimtarisë.
10. Kur BQK përdor instrumentin e shitjes së veprimtarisë për të transferuar vetëm një pjesë të aseteve, të drejtave ose detyrimeve të bankës në proces të përmbylljes, pjesa e mbetur e bankës ose banka nga e cila asetet, të drejtat ose detyrimet janë transferuar, do t'i nënshtrohet procedurave të rregullta të likuidimit.
11. Në pajtim me paragrafin 8 të nenit 102 të Ligjit për Bankat, BQK dhe Fondi Kombëtar i Përmbylljes mund të rimarrin çdo shpenzim të arsyeshëm të shkaktuar me përdorimin e

instrumenteve dhe kompetencave të përmbylljes ose të instrumenteve të qeverisë për stabilizim financiar në një ose disa nga mënyrat e mëposhtme:

- 11.1. si shumë e zbritshme nga çdo vlerë e paguar nga një pranues i bankës në proces të përmbylljes ose, sipas rastit, për pronarët e aksioneve ose instrumenteve të tjera të pronësisë;
- 11.2. nga banka në proces të përmbylljes, si një kreditor i preferuar; ose
- 11.3. nga çdo e hyrë e gjeneruar si rezultat i ndërprerjes së funksionimit të institucionit urë ose subjektit për menaxhimin e aseteve, si një kreditor i preferuar.

Neni 4

Kushtet e shitjes

1. Shitja e përcaktuar në nenin 3 paragrafët 3 dhe 4 të kësaj rregullore, kryhet me kushte tregu, dhe BQK ndërmerr të gjitha masat e arsyeshme për të siguruar kushtet më të favorshme të mundshme të shitjes, duke u bazuar në vlerësimin e kryer në përputhje me Ligjin për Bankat dhe rregullativen e BQK-së për vlerësimin në procesin e përmbylljes.
2. Shuma e realizuar nga shitja, e zvogëluar sipas përcaktimeve në nenin 3, paragrafi 11 të kësaj rregullores, i paguhet:
 - 2.1. pronarëve të aksioneve ose instrumenteve të tjera të pronësisë, kur shitja e aksioneve ose instrumenteve të pronësisë është realizuar përmes transferimit të këtyre instrumenteve nga mbajtësi i tyre te blerësi; dhe
 - 2.2. bankës në proces të përmbylljes, kur shitja e aseteve, të drejtave ose detyrimeve të bankës në proces të përmbylljes është realizuar, tërësisht ose pjesërisht, përmes transferimit të tyre nga banka në proces të përmbylljes te blerësi.
3. Pas zbatimit të shitjes së përcaktuar në nenin 3, paragrafët 3 dhe 4 të kësaj rregulloreje, BQK mund, me pëlqimin e blerësit, duke përfshirë rastet kur ky pëlqim është dhënë në marrëveshjen e shitjes ose në instrumentin e transferimit, të transferojë prapa te banka në proces të përmbylljes ose te mbajtësit fillestar, asetet, të drejtat, detyrimet, aksionet ose instrumentet tjera të pronësisë.
4. Në rastet kur zbatohet instrumenti i shitjes së veprimtarisë tregtare, vlerësimi i kryer sipas nenit 102 të Ligjit për Bankat dhe rregullores përkatëse për qëllime të përmbylljes do të përcaktojë, sipas rastit, vlerat e shitjes të aseteve, të drejtave, detyrimeve, aksioneve ose instrumenteve të tjera të pronësisë që do të transferohen, duke marrë parasysh periudhën e pritshme të marketingut, kostot e shitjes dhe, kur është relevante, vlerën e pritshme të garancive, përmirësimit të cilësisë së kredive (ang. credit enhancement) ose vlerës së franshizës.
5. Kur, për shkak të urgjencës së rrethanave, nuk është e mundur të përfundohet një vlerësim i plotë në përputhje me kërkesat e Ligjit për Banka dhe rregullores përkatëse të BQK-së për zbatim të instrumentit të shitjes së veprimtarisë tregtare, mjafton të bëhet një vlerësim i përkohshëm, me kusht që ai të jetë i drejtë, i kujdesshëm dhe real dhe i cili përfshinë një rezervë të përshtatshme për humbjet shtesë.
6. Kur instrumenti i shitjes së veprimtarisë tregtare është zbatuar, vlerësimi i përkohshëm sipas paragrafit 5 të këtij neni mund të shërbejë si bazë për transferimin dhe për përcaktimin e kushteve komerciale të transferimit, dhe nuk do të kërkohej një vlerësim përfundimtar (ang. ex post valuation) për qëllimet e kësaj rregulloreje vetëm për shkak se vlerësimi fillestar ka qenë i

përkohshëm. Kjo është pa paragjykuar çdo vlerësim të veçantë që kërkohet sipas Ligjit për Bankat për të vlerësuar nëse aksionarët dhe kreditorët do të kishin marrë trajtim më të mirë në procedurat e rregullta të likuidimit.

Neni 5

Detyrimet e blerësve

1. Në rast të shitjes së asetëve, të drejtat ose detyrimet të bankës në proces të përmbylljes, blerësi duhet të disponojë të gjitha licencat përkatëse për ushtrimin e veprimtarisë që është subjekt i shitjes. Në rastet kur blerësi nuk posedon një licencë të tillë, BQK, si autoritet mbikëqyrës, shqyrton kërkesën për licencim të blerësit brenda një afati të arsyeshëm.
2. Në rast të shitjes së aksioneve ose instrumenteve të tjera të pronësisë të bankës në proces të përmbylljes, blerësi që fiton interes të kualifikuar te banka në proces të përmbylljes, pa paragjykuar paragrafin 5 të këtij neni, në momentin e blerjes duhet ta ketë miratimin nga BQK për të fituar interes të kualifikuar, në përputhje me Ligjin për Bankat dhe rregulloret përkatëse në zbatim të tij.
3. BQK si autoritet mbikëqyrës, merr vendim lidhur me kërkesën për përvetësimin e interesit të kualifikuar të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, brenda një afati të arsyeshëm nga paraqitja e kërkesës.
4. Si përjashtim nga paragrafi 2 dhe 3 të këtij neni, nëse vonesat në realizimin e shitjes do të pengonin arrijtjen e objektivave të përmbylljes të përcaktuara në nenin 100 të Ligjit për Bankat, shitja mund të realizohet para përfundimit të afatit për marrjen e vendimit mbi kërkesën e përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni, ndërsa BQK, si autoritet mbikëqyrës, merr vendim lidhur me kërkesën për përvetësimin e interesit të kualifikuar në një moment të mëvonshëm.
5. Kur blerësi ka përvetësuar një interes të kualifikuar në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni, kontrata e shitjes prodhon efekt juridik dhe transferimi i pronësisë mund të realizohet para marrjes së miratimit të përmendur në këtë nen nga BQK si autoritet mbikëqyrës, por të drejtat e votës dhe të drejtat e tjera të menaxhimit që lidhen me instrumentet e pronësisë i transferohen BQK-së, e cila nuk ka detyrim t'i ushtrojë këto të drejta votimi dhe nuk mban asnjë përgjegjësi për ushtrimin ose mos ushtrimin e tyre.
6. Pas marrjes së miratimit për përvetësimin e interesit të kualifikuar sipas paragrafit 5 të këtij neni, të drejtat e votimit që rrjedhin nga këto instrumente të pronësisë transferohen nga BQK te blerësi.

Neni 6

Pasojat e refuzimit të kërkesës për miratimin e përvetësimit të interesit të kualifikuar

1. Kur BQK, si autoritet mbikëqyrës, në pajtim me Ligjin për Bankat, refuzon kërkesën për miratimin e përvetësimit të interesit të kualifikuar te banka në proces të përmbylljes, të drejtat e votimit dhe të drejtat e tjera të menaxhimit që rrjedhin nga këto aksione vazhdojnë të mbahen nga BQK, e cila mund të urdhërojë shitjen e aksioneve nga blerësi brenda afatit të caktuar.
2. Transferimet që rrjedhin nga zbatimi i instrumentit të shitjes së veprimtarisë i nënshtrohen masave mbrojtëse të parashikuara në nenin 117 të Ligjit për Bankat si dhe rregullativen e BQK-së në zbatim të atij neni.

Neni 7

Masat mbrojtëse

1. Gjatë përcaktimit të fushëveprimit të transferimit në kuadër të instrumentit të shitjes së veprimtarisë, BQK siguron që ky veprim të jetë në pajtueshmëri me dispozitat e përcaktuara në nenin 117 të Ligjit për Bankat dhe rregulloren përkatëse në zbatim të këtij neni.
2. BQK do të sigurojë që një transferim të mos ndajë, shkëpusë apo në ndonjë mënyrë tjetër të ndikojë negativisht në marrëveshjet e mbrojtura, përveç rasteve kur kjo lejohet shprehimisht me Ligjin për Bankat apo rregulloren përkatëse.
3. Për qëllimet e paragrafit 2 të këtij neni, marrëveshjet e mbrojtura përfshijnë, së paku, marrëveshjet e siguruara (kolateralizuara), marrëveshjet e kolateralit financiar me transferim të titullit, marrëveshjet e kompensimit (ang. set-off arrangements), marrëveshjet e netimit, marrëveshjet për obligacionet e mbuluara (ang. covered bonds) dhe marrëveshjet e financimit të strukturuar (ang. structured finance).

Neni 8

Të drejtat e blerësve, aksionarëve dhe kreditorëve

1. Blerësi sipas nenit 5 paragrafi 1 të kësaj rregullore mund të vazhdojë ushtrimin e të drejtave të anëtarësimit, si dhe qasjen në sistemet e pagesave, kliringut dhe të shlyerjes, në bursë dhe në skemën e sigurimit të depozitave të bankës në proces të përmbylljes, me kusht që të përmbushë kriteret për pjesëmarrje në këto sisteme. Qasja në këto sisteme nuk mund të mohohet për arsye se blerësi nuk zotëron një vlerësim (ang. rating) nga një agjenci e vlerësimit kreditor ose se ky vlerësim nuk përputhet me nivelin e vlerësimit të kërkuar për dhënien e qasjes në këto sisteme.
2. Kur blerësi nuk i përmbush kriteret e anëtarësimit ose të pjesëmarrjes për qasje në sistemet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, BQK dhe/apo autoriteti përkatës kompetent për miratimin e anëtarësimit dhe të qasjes në këto sisteme mund të lejojnë ushtrimin e këtyre të drejtave për një periudhë të caktuar, jo më të gjatë se 24 muaj nga data e shitjes së aseteve, të drejtave dhe detyrimeve të bankës në proces të përmbylljes. Ky afat mund të zgjatet edhe për 12 muaj të tjerë, me kërkesë të blerësit.
3. Aksionarët ose kreditorët e bankës në proces të përmbylljes, si dhe palët e treta të tjera, asetet, të drejtat ose detyrimet e të cilëve nuk janë shitur përmes instrumentit të shitjes së veprimtarisë, nuk kanë asnjë të drejtë mbi ose në lidhje me asetet, të drejtat ose detyrimet e shitura, me përjashtim të së drejtës për masat mbrojtëse të parashikuara në nenin 117 të Ligjit për Bankat dhe rregulloren e BQK-së në zbatim të tij.
4. Blerësi konsiderohet pasardhës ligjor i bankës në proces të përmbylljes dhe mund të vazhdojë ushtrimin e çdo të drejte që është ushtruar nga banka në proces të përmbylljes në lidhje me asetet, të drejtat ose detyrimet e transferuara.

Neni 9

Kërkesat procedurale në lidhje me instrumentin e shitjes së veprimtarisë tregtare

1. Procesi i shitjes së aseteve, të drejtave ose detyrimeve, aksioneve ose instrumenteve të tjera të pronësisë të bankës në proces të përmbylljes kryhet nga BQK. BQK i ndërmerr të gjitha hapat e

arsyeshëm për shitjen dhe marketingun me kushte tregu në pajtim me vlerësimin e kryer sipas nenit 102 të këtij Ligjit për Bankat dhe rregullores përkatëse të BQK-së. Shpenzimet e shitjes dhe marketingut do të mbulohen nga banka në proces të përmbylljes.

2. Procesi i shitjes së përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni kryhet në përputhje me parimet e mëposhtme:
 - 2.1. Transparencë, prezantimi sa më i saktë të jetë e mundur i aseteve, të drejtave, detyrimeve, aksioneve ose instrumenteve të tjera të pronësisë të bankës në proces të përmbylljes, duke pasur parasysh nevojën për ruajtjen e stabilitetit financiar;
 - 2.2. Trajtim i barabartë i blerësve potencialë, duke pasur parasysh konkurrencën e drejtë ndërmjet blerësve;
 - 2.3. Parandalimi i çdo konflikti interesi;
 - 2.4. Urgjenca e procedurave të përmbylljes; dhe
 - 2.5. Siguron në masën më të madhe të mundshme dhe duke marrë parasysh rrethanat e rastit, maksimizimin e çmimit të shitjes së aksioneve ose instrumenteve të tjera të pronësisë, aseteve, të drejtave ose detyrimeve të përfshira.
3. Me përjashtim nga paragrafi 2 i këtij neni, BQK mund të kufizoj rrethin e blerësve potencial, të organizoj shitjen e targetuar, të vonoj publikimin e procesit të shitjes apo të organizoj shitjen direkt me një blerës të veçantë, dhe shitja e tillë nuk përbën shkelje të parimit të barazisë midis blerësve potencialë, të përcaktuar në nën-paragrafin 2.2 të paragrafit 2, të këtij neni, vetëm atëherë kur BQK vlerëson se:
 - 3.1. ekziston një kërcënim i konsiderueshëm për stabilitetin financiar që rrjedh nga dështimi i mundshëm i bankës në proces të përmbylljes; dhe
 - 3.2. pajtueshmëria me parimet e paragrafit 2 të këtij neni, përfshirë marketingun më të gjerë ose publikimin, do të kishte gjasa të cenonte efektivitetin e instrumentit të shitjes së veprimtarisë tregtare ose do ta bënte të vështirë arritjen e një ose më shumë objektivave të përmbylljes për të shmangur efektet e konsiderueshme negative në stabilitetin financiar.
4. Para zbatimit të paragrafit 3 të këtij neni, BQK do të dokumentoj arsyet e një vlerësimi të tillë, përfshirë faktorët e marrë në konsideratë në lidhje me urgjencën, konfidencialitetin, besimin e tregut, rrezikun e shpërndarjes, realizueshmërinë operationale dhe përshtatshmërinë e blerësve potencialë.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas miratimit nga Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Dr. Sc. Bashkim Nurboja

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës